

VENDIM
Nr. 378, datë 6.6.2012

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË, PËR
LEHTËSIMIN E PASOJAVE TË SHKAKTUARA NGA TËRMETI NË VERI TË
ITALISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave, t’i shtohet kundërvlefë e fondit prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) eurosh, për t’iu dhënë si ndihmë financiare qeverisë së Republikës së Italisë për lehtësimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti në veri të Italisë.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha